

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i përgjithshëm-divizioni penal, me gjyqtarin individual Mustaf Tahiri dhe me sekretaren juridike Gentiana Jashari, në çështjen penale kundër të pandehurve R.U. nga Ferizaj për shkak të veprës penale lëndim i rendë trupor nga neni 189 par.1 nënpar 1.3 të KPRK-së, A.U. nga Ferizaj për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, Sh.B. nga Ferizaj për shkak të veprave penale lëndim i rendë trupor nga neni 189 par.1 nënpar 1.3 dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, H.B. nga Ferizaj për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së dhe M.U. nga Ferizaj për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II.nr.811-5/16 të dates 25.07.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 02.08.2016, në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit shtetit Visar Musa, përfaqësuesi ligjor i të dëmtuarit Q.B. prindi i tij D.B. si dhe të akuzuarve R.U., A.U. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.R.Sh., Sh.B. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av. R.A., H.B. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.I.H. dhe i akuzuari M.U. dhe mbrojtësi i tij me autorizim av.B.S., të njejtën ditë mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 10.08.2016 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

- 1. R.U.**, nga Ferizajt rruga “.....”, data e lindjes....., në fshatin Komuna Ferizaj, nga i ati F. dhe e ëma B., e gjinisë P., i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes se mesme ekonomike, i pa martuar shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës .

2. **A.U.** nga Ferizajt rruga “.....”, data e lindjes....., në fshatin Komuna Ferizaj, nga i ati F. dhe e ëma B....., e gjinisë P....., i pa martuar ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes se mesme ekonomike, i pa martuar shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës .
3. **SH.B.** nga Ferizajt rruga “.....”,data e lindjes....., në fshatin K.Ferizaj, nga i ati R. dhe e ëma H. e gjinisë Sh., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
4. **H.B.** nga Ferizajt rruga “.....”,data e lindjes....., në fshatinK.Ferizaj, nga i ati D. dhe e ëma H. e gjinisë Sh....., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.
5. **M.U.** nga Ferizajt rruga “.....”,data e lindjes....., në fshatin Komuna Ferizaj, nga i ati F..... dhe e ëma B.... e gjinisë P....., i gjendjes se mesme ekonomike, i martuar, ka të kryer shkollën fillore, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

Sepse

I. R.U.

me date 28.05.2016, rreth ores 16.00, në rr.”.....” në Ferizaj, pas një mosmarveshje të mëhershme në mes familjarëve të tij dhe familjes B., pasi i pandehuri R.U. kishte kuptuar këtë kishte shkuar në oborrin e familjes B. me villain e tij M.U., aty siuate tensionohet me ç`rast fillon rrahja në mes tyre ku i pandehuri R.U. me një lopatë mjeët i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor , ka goditur të dëmtuarin- të miturin Q.B., në pjesën e kokës-fytyrës dhe nofullës ku nga pasojat e kësaj goditje ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe atë thyerje e qafës së anës së majtë të kockës së nofullës së sipërme të anës së majtë të gojës, thyerje e murit anësor të zgavrës së syrit të majtë dhe gjakmbledhje nënllëkurore të regjionit muror të anës së djathtë të kokës, të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të forte mbretës (jo i mprehtë, i topitur), e të cilat lëndime bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore,

me të cilën kreu veprën lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së.

II. SH.B.

Me datë dhe vend si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, pas një mosmarrëveshje të mëhershme në mes familjarëve të tij dhe familjes U., pasi që R.U. kishte shkuar në oborrin e familjes B. me vëllain e tij M.U., aty situata tensionohet, me ç`rast fillon rahja në mes tyre ku i pandehuri Sh.B. me një sopatë, mjetë i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor, ka goditur të dëmtuarin R.U. në pjesën e kokës në anën e djathtë, e pastaj në krahun e djathtë dhe në fytyrë, ku nga pasojat e këtyre goditjeve ka pësuar lëndime të rënda trupore dhe atë thyerje e ulnës së parakrahut të dorës së djathtë, të shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë), e të cilat lëndime bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore,

me të cilën kreu veprën lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së.

III. A.U., H.B., M.U. DHE SH.B.,

Me datë 28.05.2016, fillimisht rreth orës 15.30, në rrugën “.....” në Ferizaj, përkatësisht të market “...”, pas një fjalosje në mes të H.B. me A.U. dhe të miturin Q.B., kanë filluar të përleshën, ku i pandehuri A.U. me një shkop mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor godet H.B. në pjesën e barkut dhe në krahun e majtë, ku pastaj i pandehuri H.B. ia merr shkopin nga dora dhe e godet të dëmtuarin A.U. në kokë dhe në kraharorin e dorës së djathtë, e pastaj rreth orës 16.00 në oborrin e familjes B. vije deri te rrahja tjetër ku i pandehuri M.U. me një shkop-bisht i thyer i lopatës mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor godet të dëmtuarin H.B. në kokë, ndërsa i pandehuri Sh.B. e godet të dëmtuarin M.U. me një shkop, mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor në kokë ku të gjithë kanë pësuar lëndime të lehta

trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin të përskruara në ekspertizën mjeko – ligjore të datës 29.06.2016.

Me të cilën kryen secili veq e veq veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së,

Andaj gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 4,6,7,21,41,43,45, dhe 73 të KPK-së, dhe neni 365 të KPPK-së, të pandehurve u,

CAKTON

- 1. Të akuzuarin R.U. e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.**
- 2. Të akuzuarin A.U. e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin dënim të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dates 28.05.2016 e deri më date 02.08.2016.**
- 3. Të akuzuarit SH.B. për veprën penale sipas pikës I të dispozitivit të aktgjyqimit e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 4 (katër) muaj ndërsa për veprën penale sipas pikës II të dispozitivit të aktgjyqimit e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj.**

Konform neni 80 të KPRK-së, të akuzuarin SH.B. e gjykon me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin

dënim dhe ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dates 28.05.2016 e deri më date 02.08.2016.

- 4. Të akuzuarin H.B., e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin dënim dhe ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dates 28.05.2016 e deri më date 02.08.2016.**

- 5. Të akuzuarin M.U., e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të cilin dënim dhe ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej dates 28.05.2016 e deri më datë 02.08.2016.**

Të dëmtuarit – përfaqësuesi i të dëmtuarit Q.B. prindi D.B. nga Ferizaj rr.”.....”, R.U., A.U., Sh.B., H.B. dhe M.U. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Obligohen të akuzuarit që në mënyrë solidare ti paguajn shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 50 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej 20 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjyqimit nën kërcënimin e përbarimit me dhunë.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.811-5/16 të dt.25.07.2016 e ka ngarkuar të pandehurin R.U. për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 nënpar 1.3 të KPRK-së, të pandehurin A.U. për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, të pandehurin Sh.B. për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 nënpar 1.3 dhe veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së të KPRK-së, të pandehurin H.B. dhe M.U. për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj çështje penale mbajti shqyrtimin fillestar më dt. 02.08.2016 në të cilin Prokurori i Shtetit Visar Musa në tërësi mbeti pranë aktakuzës duke i propozuar gjykatës që të pandehurit ti shpallë fajtor dhe të dënohen sipas ligjit.

I pandehuri R.U., ne shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 nënpar 1.3 të KPRK-së për të cilat e ngarkon aktakuza, duke theksuar se për këtë veprë është penduar thellë, se duke premtuar se ë të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

I pandehuri A.U., ne shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 i KPRK-së, duke theksuar se për këtë veprë është penduar thellë, se duke premtuar se ë të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

I pandehuri Sh.B., ne shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprat penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 nënpar 1.3 dhe veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së për të cilat e ngarkon aktakuza.

I pandehuri H.B., I pandehuri R.U., ne shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 nënpar 1.3 të KPRK-së për të cilat e ngarkon aktakuza, duke theksuar se për këtë veprë është penduar thellë, se duke premtuar se ë të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, duke e lutur gjykatën që ti shqipton ndonjë dënim sa më të butë.

I pandehuri M.U., ne shqyrtimin fillestar, me rastin e njoftimit për të drejtën e tij që të pranoj fajësinë apo të deklarohet i pa fajshëm në kuptim të nenin 248 të KPPK-së, ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, duke theksuar se për këtë veprë është penduar për këtë veprë penale dhe duke kërkuar falje për atë që ka ndodhur.

Me që të pandehurit kanë pranuar fajësinë gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së:

- Të pandehurit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit,
- pranimi është bërë vullnetarisht nga t pandehuri, pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre,
- pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe ne provat tjera te cilat gjinden ne shkresën e lendes siç janë: mendimi dhe konstatimi i ekspertit të mjekësisë ligjore i dt.29.06.2016 dhe i dt.13.07.2016, deklaratat e të dëmtuarve si dhe t, vërtetimi mbi kthimin e sendeve të dt.15.05.2016, deklarata e të pandehurit R.U., A.U., Sh.B., H.B. dhe M.U. si dhe dokumentacioni i cili gjendet ne shkresat e lëndës, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabim faktik.

Meqenëse të pandehurit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 248 par.1 të KPPK-së, gjyqtari individual konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mund të vazhdoj procesin me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa e mbajtur fare shqyrtimin gjyqësorë, lidhur me këtë shih mendimin juridik te Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të dt.19.03.2013*).

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit R.U. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, të përshkruar si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi. Gjithashtu vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se edhe në veprimet e të pandehurit A.U. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, të përshkruar si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e tretë të këtij aktgjykimi. Poashtu vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se edhe në veprimet e të pandehurit Sh.B. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par.1 nënpar 1.3 të KPRK-së, të përshkruar si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e dytë të këtij aktgjykimi si dhe të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, të përshkruar si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e tretë të këtij aktgjykimi. Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe veprimet e të pandehurve H.B. dhe M.U. dhe gjeti se në veprimet e këtyre të pandehurve manifestohen gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 të KPRK-së, të përshkruar si në datën, kohën dhe vendin siç është përshkruar në dispozitivin e tretë të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, për të pandehurin R.U. si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, se është i martuar dhe prind i dy fëmijëve, pendimin e tij të shprehur për kryerjen e kësaj vepre penale, ndërsa si rrethanë rënduese vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të te pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, ndërsa si rrethanë veçanërisht rënduese gjykata për të pandehurin mori shkallën e dëmit të shkaktuar, moshën e të dëmtuarit ku i dëmtuari ka qenë i mitur. Për të pandehurin A.U. si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, pendimin e tij të shprehur për kryerjen e kësaj vepre penale, si rrethanë rënduese vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të te pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale. Për të pandehurin Sh.B. si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, se është i martuar, i pa punë, pendimin e tij të shprehur për kryerjen e kësaj vepre penale, ndërsa si rrethanë rënduese vlerësoi shkallen e përgjegjësisë penale të te pandehurit

dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, shkallën e dëmit të shkaktuar ku i pandehuri Sh.B. u ka shkaktuar lëndime trupore dy të dëmtuarve. Për të pandehurin H.B. si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, pendimin e tij të shprehur për kryerjen e kësaj veprë penale, se është i martuar, ndërsa si rrethanë rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të te pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale. Gjiashtu edhe për të pandehurin M.U. gjykata me rastin e matjes së llojit të dënimit si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë, sjelljen e tij korrekte, pendimin e tij të shprehur për kryerjen e kësaj veprë penale, se i njëjti është i martuar, ndërsa si rrethana rënduese vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të te pandehurit dhe rrezikshmerinë konkrete të veprës penale, andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave dhe shkallën e përgjegjësisë penale si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale, gjykata te pandehurve u vërtetoi dënim me burgim si në dispozitivet e këtij aktgjykimi me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i përgjithëshëm i dënimit, në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku dënimet e shqituara nga gjykata për secilin të pandehur janë adekuate dhe janë proporcione të drejtë në raport me peshën e veprës penale të kryer nga secili i pandehur, rrethanave të kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të pandehurve.

Të dëmtuarit – përfaqësuesi i të dëmtuarit Q.B. prindi D.B. nga Ferizaj rr.”.....”, R.U., A.U., Sh.B., H.B. dhe M.U. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest civil.

Konform nenit 367 par.1 pika 1.2 të KPPRK-së me aktvendimin P.nr.710/16 të dt.02.08.2016 me dt.02.08.2016, të akuzuarve A.U., Sh.B., H.B. dhe M.U., u është ndërprerë masa e paraburgimit.

Konform nenit 83 të KPRK-së, në dënimin e shqiptuar me burgim të pandehurve A.U., Sh.B., H.B. dhe M.U., u është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej prej dates 28.05.2016 e deri më date 02.08.2016.

Obligohen të akuzuarit që në mënyrë solidare ti paguajn shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 50 € si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej 20 €, të

gjitha këto në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotëfuqishmerisë së aktgjykimit nën kërcnimitin e përbarimit me dhunë.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- Departamenti i përgjithshëm-divizioni
penal, P.nr.710/16, dt.10.08.2016**

Sekretarja Juridike ,
Gentiana Jashari

Gjyqtari,
Mustaf Tahiri

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa

Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej

15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.